



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1764/10 prot.,

Datë 21.07.2025

V E N D I M
Nr. 935/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.07.2025 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 886/2025, datë 10.07.2025 për procedurën e prokurimit prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”-Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ku për secilin lot do të shpallet një operator ekonomik fitues.”, me Nr. REF-50051-06-03-2025, me objekt: Loti 2: “Mirëmbajtje automjete për Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë”, me fond limit 5,500,000 (pesë milion e pesëqind mijë)lekë pa TVSH zhvilluar më datë 16.06.2025, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “AEE SERVICE” SHPK, me Nipt. L81530012C Adresa: Rruga dytësore, mbikalimi i Kasharit, objekt në zonën kadastrale 2105, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a
Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të

Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 10.07.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 886/2025, ku vendosi:

[.....]

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “AEE SERVICE” SHPK,, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”-Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ku për secilin lot do të shpallet një operator ekonomik fitues”, me Nr. REF-50051-06-03-2025, me objekt: Loti 2: “Mirëmbajtje automjete për Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë”, me fond limit 5,500,000 (pesë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH zhvilluar më datë 16.06.2025, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar duke kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit në zbatim të vendimit të KSHA-së.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “AEE SERVICE” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.” [...]

I.2. Me shkresën nr. 1740/14 prot., datë 16.07.2025, protokolluar me tonën nr. 1764/7 prot., datë 17.07.2025, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 886/2025 datë 10.07.2025 duke i bashkëngjitur shkresës procesverbalin e rivlerësimit të ofertave.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 1740/14 prot., datë 16.07.2025, protokolluar me tonën nr. 1764/7 prot., datë 17.07.2025, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 886/2025 datë 10.07.2025 duke i bashkëngjitur shkresës procesverbalin e rivlerësimit të ofertave.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, si dhe dokumentacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik duke kualifikuar operatorin ekonomikë “AEE SERVICE” SHPK në përputhje me vendimin e KPP Nr. 886/2025, datë 10.07.2025

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit Procedurë e hapur e thjeshtuar”-Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ku për secilin lot do të shpallet një operator ekonomik fitues.”, me Nr. REF-50051-06-03-2025, me objekt: Loti 2:“Mirëmbajtje automjete për Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë”, me fond limit 5,500,000 (pesë milion e pesëqind mijë)lekë pa TVSH zhvilluar më datë 16.06.2025, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a..
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

